

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-1938/2

11.08.2023

Kërçovë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 24-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 11.08.2023 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10 e 20 minuta.

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamer Klosi, Drenuse Dalipi, Valbona Adili Emini, Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Argjent Asani, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulfeari, Fortesa Sejdini dhe Sibel Tufkegji.

Në mungesë ishte këshilltari Migjen Zendeli.

Në seancë morrën pjesë edhe përfaqësues të administratës komunale të Komunës së Kërçovës: Burim Kadriu, Bekim Mustafaj, Aneta Nasteska- Sekretare e Komunës së Kërçovës, Drejtorët e „Hristo Uzunov“, Dërgovë, dhe IPK Qerdhja për Fëmijë „Ollga Miceska“, Kërçovë

Kryetari i këshillit informoi se Procesverbali nga mbledhja paraprake e mbajtur më datë 18.07.2023 do të miratohet në mbledhjen e ardhëshme, përshkak se nuk është gati.

Kryesuesi e lexoi propozim rendin e ditës si vijon.

Propozim rendi i ditës

1. Miratimi i Raportit kuartal për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për kuartalin e 2 për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023.

2. Propozim Vendim për zgjerim dhe ridestitim të mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2023.

3. Propozim Vendim për dhënien e mendimit pozitiv të Planit vjetorë për punësim të Komunës së Kërçovës për vitin 2024.

4. Propozim Vendim për dhënien e ndihmës së njëhershme financiare për vitin shkollorë 2022/2023 për vend të parë të fituar në nivel shtetërorë për shkollat fillore komunale.

5. Miratimi i Raportit për punë të IPK – Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2022/2023.

6. Miratimi i Programit vjetorë për punë të IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2023/2024.

7. Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2024 dhe balanserit në IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë.

8. Propozim Kërkesë për rritje dhe zvoglim të kapaciteteve për regjistrim të fëmijëve në IPK Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë.

9. Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2023 të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë.

10. Propozim vendim për sjelljen e propozimit për përmisimin e gabimit teknik në pjesën tabelare nga plani urbanistik për PN 1.25, Blloku 1, në PDU, për pjesë nga lagja “Nën Varosh”, Komuna e Kërçovës, i sjellur me vendim këshilli me nr.07-1618/3 nga dt.05.07.2012, me periudhë plani 2011/2016.

11. Të ndryshme.

Mihajlo Daniloski - Ai informoi se kanë dorëzuar një Propozim - Vendim për ridestitim e mjeteve dhe ka menduar që ky propozim duhet të jetë pikë në rendin e ditës të kësaj seance.

Laze Jakimoski- Informon se në lidhje me propozim-vendimin kanë kërkuar që mjetet prej një milion e dyqindmijë dhe në një vendim tjetër 400.000, të ndahen veçmas. Në lidhje me pikën për mbështetjen financiare të nxënësëve për fitimin e vendit të parë në gara shtetërore, ai pyeti se çfarë është ridestituar në Propozim-Vendim nga pika e dytë e rendit të ditës. Ai theksoi se Vendimi është i përgjithshëm, nuk është

specifikuar as për nxënësit e as për mentorët, dhe pyeti se pse mentorëve iu është hequr mbështetja financiare përkundër faktit se atyre u kanë mbetur rreth 80 mijë denarë nga 440 mijë, nëse u merreshin 314 mijë për vauçera për nxënësit e klasës së parë.

Burim Kadriu- Informon se propozimi i VMRO-së në Këshill për ndarjen e Vendimit në dy Vendime nuk qëndronte dhe duhej të ishte në një Vendim, sepse ishte një tërësi dhe në të ishin bartur mjetet nga një zë në tjetrin. Ai theksoi se tani do të kishte një periudhë të dytë regjistrimi dhe numri i nxënësve të klasës së parë do të jetë rreth 400 fëmijë.

Laze Jakimoski - Ai informon se vitin e kaluar numri ka qenë 295 fëmijë dhe për fat të keq numri është në rënie, duke mos u rritur nga viti në vit. Shpjegimi i Burimit nuk qëndron, Vendimi ka mundur të ndahet në dy vendime dhe të shpërndahet sipas zërave. Ai kërkoi ndryshimin e rendit të ditës dhe Propozim-Vendimin e tyre për zgjerimin dhe ridestininim e mjeteve në buxhetin e Komunës së Kërçovës të futet në rend dite.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim propozimin e këshilltarit Mihailo si pikë shtesë në rendin e ditës me pikë të re të propozuar dhe nuk u miratua me 9 vota PËR, 11 vota KUNDËR dhe 2 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim rendin e ditës së propozuar dhe i njëjti u miratua me 15 vota PËR, 6 vota KUNDËR dhe 1 votë PËRMBAJTUR.

1. PIKA E PARË: Miratimi i Raportit kuartal për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës përkuartalin e 2 për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023.

Kryetari i Komisionit për Financa dhe Buxhet ka lexuar Raportin e seancës së mbajtur të Komisionit për Financa.

Burim Kadriu-Informon se pikat që janë në kompetencë të komisionit janë shqyrtuar nga komisioni dhe deri më 30.06.2023 ka pasur realizim të buxhetit prej 46.5%. Në shembullin K2 janë të parashtruara detyrimet e komunës ndaj subjekteve, të cilat janë zvogluar nga 78 në 7 milionë. Në formularin K3 nuk ka pasur parashtrës, sepse nuk ka pasur kredi.

Agim Sadiku – Theksoi se në këtë pikë nuk mund të ndryshohej asgjë, kaq dhe vetëm duhej që të konstatohet. Kam kërkuar shpjegime më të detajuara që të bëhet një krahasim për uljet dhe rritjet nga vitet e kaluara. Ai ka theksuar se në krahasim me vitin e kaluar realizimi i buxhetit ka qenë i ngjashëm, por realizimi i tatimit në pronë është zvogëluar.

Mihajlo Daniloski - Ai informon se ka një sugjerim teknik për Sekretaren, që në të ardhmen gjatë përgatitjes së Vendimeve të përdoret gjuha maqedonase me alfabet kirilik, e jo gjysma e vendimit të shkruhet në kirilic dhe gjysma në latinisht.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Miratimi i Raportit kuartal për realizim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës përkuartalin e 2 për periudhën 01.01.2023 deri 30.06.2023 dhe i njejt i miratua me 13 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 9 vota PËRMBAJTUR.

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për zgjerim dhe ridestitim të mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2023.

Burim Kadriu- Informon se janë bërë dy ndryshime në buxhet. Banesat sociale për komunitetin rom po ndërtohen me fonde të Bashkimit Evropian dhe komuna ka një marrëveshje bashkëfinancimi. Shuma e zërit për sport dhe rekreacion zvogëlohet dhe shpërndahet për të. Ndryshimi tjetër është për ndihmë financiare dhe kupon prej 1000 denarë për çdo nxënës të klasës së parë dhe ndihmë financiare për nxënësit për fitimin e vendit të parë në garat shtetërore.

Laze Jakimoski - Ai pyeti se pse nuk ishin paraparë ato mjete në vitin 2020 kur është nënshkruar Marrëveshja dhe pse janë marrë mjete nga Programi për sport dhe rekreacion dhe ndërtim të objekteve kapitale.

Burim Kadriu – Informon se për momentin ka pasur një Thirrje Publike nga Bashkimi Evropian, i cili duhet që të realizohet. Bartës i projektit ishte Shoqata nga Prilepi, ndërsa komuna është bashkëfinancuese me 10%. Mjete nuk ishin paraparë, sepse kishte probleme në realizimin e projektit.

Laze Jakimoski - Ai pyeti pse vendimi për vauçerë për nxënësit e klasës së parë prej 440 mijë denarë nuk është në rend dite.

Burim Kadriu - Informon se komuna ka pasur përvojë me vauçerë të tillë që kanë ndihmuar gjatë Covid-it dhe për komunitetin rom. Është dashur të miratohet një Rregullore, të krijohet Komisioni për realizimin e vauçerëve dhe të shpallet Thirrja publike.

Laze Jakimoski - Ai theksoi se Rregullorja duhet të kalojë në këshill.

Burim Kadriu- Informon se shkollat do të japin të dhëna për numrin e nxënësve të klasës së parë.

Valentina Lazarevska- Informon se propozimi ka ardhur nga Grupi Këshilltarëve të VMRO-së, dhe se tani janë regjistruar 314 nxënës të klasës së parë dhe ka pasur

informacione se ky numër do të zvogëlohet, dhe jo të rritet, për shkak të emigrimit të qytetarëve nga vendi. Ajo theksoi se shuma prej një mijë denarë për një nxënës të klasës së parë është e vogël, si ndihmë për prindërit dhe në të ardhmen në buxhet duhet të parashikohet një shumë më e madhe për këtë.

Mihajlo Daniloski – Ai informon se këtë e kanë kërkuar që dy vite me rradhë dhe tani do të realizohet, por ka qenë kundër një ridestinimi të tillë të mjeteve.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për zgjerim dhe ridestinim të mjeteve në Buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2023 dhe i njejtë u miratua me 12 vota PËR. 6 vota KUNDËR. 4 vota PËRMBAJTUR.

Abdulla Sejdini- Ai bën të ditur se i duket e çuditshme që po votojnë kundër ndërsa propozimi ka qenë i tyre.

Laze Jakimoski- Informon se një nga arsyet që kanë votuar kundër është se do të merren mjete nga kompletimi i sallës sportive “Jançica”, siç informoi Burimi.

Abdulla Sejdini - Ai bën me dije se gjithsesi është dashur ta përkrahin vendimin, sepse propozimin e kanë bërë të parët vetë ato, e në lidhje me vauçerin prej 1 mijë denarë për nxënësin e klasës së parë ka theksuar se shuma është e vogël dhe në të ardhmen pritet të jetë më e madhe.

3. PIKA E TRETË: Propozim Vendim për dhënien e mendimit pozitiv të Planit vjetorë për punësim të Komunës së Kërçovës për vitin 2024.

Sekretarësha e Komunës – Informon se Plani Vjetor i Punësimit për vitin 2024 ka qenë i njëjtë me atë të vitit 2023, ka pasur ndryshime vetëm te pensionet. Ajo theksoi se në planin për maqedonasit në vend të 89, duhej të ishin 82, ndërsa te pensionet nuk ishte përcaktuar një numër të saktë, sepse nuk kishin të dhëna për zjarrfikësit që kanë qenë me përvojë pune me beneficion.

Sibel Tufekgji- Ajo pyeti se me cilat kritere hartohet plani.

Sekretarësha e Komunës - Bën me dije se numri përcaktohet sipas balansarit, ndërsa për profilin e të punësuarëve tregojnë Udhëheqësit e sektorëve dhe njësave.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për dhënien e mendimit pozitiv të Planit vjetorë për punësim të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 dhe u miratua me 14 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 7 vota PËRMBAJTUR.

4. PIKA E KATËRT: Propozim Vendim për dhënien e ndihmës së njehershme financiare për vitin shkollorë 2022/2023 për vend të parë të fituar në nivel shtetërorë për shkollat fillore komunale.

Sekretarsha - Informon se kjo pikë është tërhequr nga rendi i ditës në seancën e paraprahe, për shkak të pikës së parë dhe të dytë që janë në rendin e ditës të kësaj seance. Ajo informon se e dinin se nuk kishte mjete në buxhet dhe duhej të parashikoheshin dhe nuk e dinin se sa nxënës e kishin fituar vendin e parë në garat shtetërore. Para do tu jepen vetëm studentëve dhe jo edhe mentorëve, sepse kështu ka vendosur menaxhmenti.

Valentina Lazarevska - Informon se në lidhje me Vendimin ka vërejtje se është dashur të qëndrojnë emrat e shkollave dhe se përveç nxënësve është dashur të shpërblehen edhe mentorët, sepse janë përkushtuar që nxënësit të arrijnë sukses të tillë.

Sekretarsha- Informon se për momentin ishte e kotë, sepse kaq ishte shuma e mjeteve.

Valentina Lazarevska-Informon se në disa shkolla mentorët e paguanin vetë tarifën e regjistrimit, sepse disa shkolla kishin llogari të bllokuara.

Laze Jakimoski - Pyeti ku janë 80.000 denarë.

Sekretarja – Informon se ato mjete janë të parapara, e jo se i ka komuna.

Laaze Jakimoski - Ai pyeti se pse mentorëve nuk u është dhënë shpërblim nga ato 80.000 denarë që kanë mbetur, sepse pa punën e tyre nxënësit nuk do të kishin arritur sukses.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Propozim Vendim për dhënien e ndihmës së njehershme financiare për vitin shkollorë 2022/2023 për vend të parë të fituar në nivel shtetërorë për shkollat fillore komunale dhe i njejtë u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). ABSTINUAR (asnjë).

5. PIKA E PESTË: Miratimi i Raportit për punë të IPK – Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2022/2023.

Drejtori i IPK-Qerdhja për fëmijë, Ollga Miceska,- shpjegoi në detaje Programin për punën të çerdhes.

Meqë askush nuk e morri fjalën, kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit për punë të IPK – Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2022/2023 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

6. PIKA E GJASHTË: Miratimi i Programit vjetorë për punë të IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2023/2024.

Drejtori i IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” shpjegoi në detaje Programin për punën e kopshtit.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Programit vjetorë për punë të IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë për vitin 2023/2024 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

7. PIKA E SHTATË: Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2024 dhe balancerit në IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë.

Drejtori i IPK- Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska”, shpjegoi në detaje Planin Vjetor të Punësimit për vitin 2024 dhe një balancues në çerdhe me punësimet dhe pensionet e planifikuara.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Planin vjetor të punësimit për vitin 2024 dhe balancuesin në çerdhen e fëmijëve “Olga Miçeska”, Kërçovë dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kalohet në:

8. PIKA E TETË: Propozim Kërkesë për rritje dhe zvoglim të kapaciteteve për regjistrim të fëmijëve në IPK Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë.

Valentina Lazarevska - Ajo pyeti se cili është zvoglimi

Drejtori- Informon se bëhet bashkimi i dy grupeve të moshave të ndryshme dhe po bëhet një grup homogjen prej 3-5 fëmijë, 4-6 fëmijë etj.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Kërkesë për rritje dhe zvoglim të kapaciteteve për regjistrim të fëmijëve në IPK Çerdhja e fëmijëve “Ollga Miceska” Kërçovë dhe e njehta u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash.

Pas pushimit seanca vazhdoi.

9. PIKA E NËNTË: Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2023 të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë.

Drejtoresha e SHF,,Hristo Uzunov,, - Informon se kjo është e nevojshme që të mund të publikohet konkursi për punësim të ri, sepse pa të nuk mund të publikohej konkursi.

Kryetari i këshillit e vendosi për Miratimi i Planit vjetorë për punësim për vitin 2023 të SHF”Hristo Uzunov” Dërgovë dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

10. PIKA E DHJETË: Propozim vendim për sjelljen e propozimit për përmisimin e gabimit teknik në pjesën tabelare nga plani urbanistik për PN 1.25, Blloku 1, në PDU, për pjesë nga lagja “Nën Varosh”, Komuna e Kërçovës, i sjellur me vendim këshilli me nr.07-1618/3 nga dt.05.07.2012, me periudhë plani 20112016.

Bekim Mustafaj - Informon se bëhet fjalë për korigjimin e një gabimi teknik, ka pasur dallim në sipërfaqen e parcelës dhe atë që është futur në Elaborat dhe për këtë arsye është dashur të barazohet paraqitja tabelare nga plani urbanistik dhe nga elaborati. .

Kryetari i këshillit vendosi për miratim Propozim vendim për sjelljen e propozimit për përmisimin e gabimit teknik në pjesën tabelare nga plani urbanistik për PN 1.25, Blloku 1, në PDU, për pjesë nga lagja “Nën Varosh”, Komuna e Kërçovës, i sjellur me vendim këshilli me nr.07-1618/3 nga dt.05.07.2012, me periudhë plani 20112016 dhe u miratua me 12 vota PËR, KUNDËR (asnjë). 9 vota PËRMBAJTUR.

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Të ndryshme

Kryetari i këshillit lexoi kërkesën e Komitetit Komunal të VMRO-DPMNE Kërçovë për ndarjen e hapësirës në Kitino Kale dhe lidhjen e rrymës për kyçjen e sistemit zanor për mbajtjen e tribunës, 33 vjet OK VMRO-DPMNE- Kërçovë- e shkuara, e tashmja, e ardhmja më 22.08.2023 në periudhën nga 18-20 orë.

Shërbimet thanë se kërkesës i është përgjigjur pozitivisht.

Më pas kryetari i këshillit lexoi kërkesën e Petres dhe Zhaklinës nga ul. “Bojan Nikolovski” nr.3, vendbanimi Ivanidol, të cilët jetojnë aty për 10 vite, kanë paguar taksa komunale, por ende nuk kanë asfalt, kanalizim, ndriçim rrugor. Ata nuk mund të nxjerrin një dokument të nevojshëm pavarësisht se emri i rrugës është miratuar me vendim të Këshillit, gjë që shihet edhe nga provat e bashkangjitura me kërkesën dhe kërkojnë zgjidhjen e kësaj.

Laze Jakimoski - Ai pyeti se a janë në dijeni ata që janë përgjegjës për ndriçimin në komunë për faktin se po vidhet rryma në afërsi të urës të “Putsko Petrol” nga ata që kanë ngritur tezga dhe po shesin dhe se dikush mund të lëndohet.

Sekretarsha- Informon se është paguar rregullisht tarifa për shfrytëzimin e tezgave dhe do të raportojnë vjedhjen e energjisë elektrike.

Meqenëse askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe kështu u shterë rendi i ditës për këtë seancë, Kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës e mbylli seancën e Këshillit në ora 12:10 minuta.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

-Elisaveta Mileska

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar

Skender Xhabiri d.v.